

20200180327

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR NDALIM DHE PARANDALIM TË KRYERJES SË VEPRIMTARISË SË PAREGJISTRUAR

Neni 1

Në Ligjin për ndalim dhe parandalim të kryerjes së veprimtarisë së paregjistruar ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 199/14 dhe 147/15), në nenin 4 në alinenë 5 fjalët: "Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë" zëvendësohen me fjalët: "Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Neni 2

Në nenin 8 paragrafi (1) fjalët: "Regjistri Qendror" zëvendësohen me fjalët: "Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Neni 3

Në nenin 9 paragrafët (2) dhe (3) ndryshohen si vijojnë:

"(2) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese inspektori nga paragrafi (1) të këtij neni përcakton se subjekti i mbikëqyrjes inspektuese ka vepruar në kundërshtim me dispozitat nga nenet 13 dhe 14 të këtij ligji, është i obliguar për parregullsinë e kryer dhe kundërvajtjen e kryer të përpilojë procesverbal në pajtim me ligj dhe me aktvendim subjektit të mbikëqyrjes inspektuese i shqipton vërejtje si masë inspektuese dhe i cakton afat në të cilën është i obliguar t'i mënjanojë parregullsitë dhe mangësitë.

(3) Nëse pas përfundimit të afatit të caktuar gjatë shqiptimit të vërejtjes nga paragrafi (1) të këtij neni, inspektori përcakton se parregullsitë dhe mangësitë ende nuk janë mënjeluar, me aktvendim shqipton masë inspektuese urdhër për mënjanimin e parregullsive dhe mangësive të përcaktuara."

Pas paragrafit (3) shtohen nëntë paragrafë të rinj (4), (5), (6), (7), (8), (9), (10), (11), dhe (12), si vijojnë:

"(4) Aktvendimi nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni, miratohet menjëherë, ndërsa më së voni në afat prej tetë ditësh nga dita e përpilimit të procesverbalit, në pajtim me ligjin.

(5) Kur gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese nuk janë përcaktuar parregullsi në pajtim me ligj ose parregullsitë e përcaktuara janë mënjeluar gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese ose në afatin e përcaktuar me aktvendimin nga paragrafi (1) të këtij neni, inspektori e ndërpret procedurën me konstatim në procesverbal, në pajtim me ligjin.

(6) Me përjashtim nga paragrafi (3) të këtij neni, inspektori mund të shqiptojë masë inspektuese me aktvendim me gojë në procesverbal, në pajtim me ligjin.

(7) Në rastin nga paragrafi (6) të këtij neni, inspektori është i obliguar, ndërsa më së voni në afatin e përcaktuar në paragrafin (4) të këtij neni, të miratojë aktvendim me shkrim për shqiptimin e masës inspektuese.

(8) Kundër aktvendimit nga paragrafët (2), (3) dhe (7) të këtij neni, mund të paraqitet ankesë në afat prej 15 ditë nga dita e pranimit të aktvendimit, te organi kompetent për vendosje në shkallë të dytë, në pajtim me ligjin.

(9) Ankesa nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit nga paragrafët (2), (3) dhe (7) të këtij neni.

(10) Organet e administratës shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale nga paragrafi (1) të këtij neni, mbajnë evidencë elektronike për vërejtje dhe kundërvajtje të shqiptuara, në pajtim me këtë ligj.

(11) Për vërejtjet e shqiptuara nga paragrafi (1) të këtij neni, gjendjen e konstatuar dhe rezultatin nga kërkesat e parashtruara kundërvajtëse dorëzojnë raport te Këshilli Inspektues.

(12) Formën dhe përmbajtjen e aktit nga paragrafi (8) të këtij neni, e përcakton funksionari i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore."

Neni 4

Në nenin 10 paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"Kur është zbatuar mbikëqyrja inspektuese nga neni 9 i këtij ligji, nëse inspektori kompetent në vendin e ngjarjes konstaton se personi juridik ose fizik edhe më tej kryen veprimtari të paregjistruar, përpilon procesverbal për gjendjen e përcaktuar faktike dhe miraton aktvendim për ndalim të kryerjes së veprimtarisë së paregjistruar deri në ditën e regjistrimit të organi kompetent shtetëror, në të cilën përcaktohet afati për regjistrim i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë."

Neni 5

Neni 11 ndryshohet si vijon:

"(1) Nëse inspektori kompetent përcakton kundërvajtje për kundërvajtjet nga nenet 13 dhe 14 të këtij ligji, para se të parashtrorë kërkesë për ngritje të procedurës të kundërvajtjes, është i obliguar personit fizik - subjekt i mbikëqyrjes inspektuese i personit përgjegjës ose person i autorizuar nga ai të punëdhënës t'i japë urdhërpagesë kundërvajtëse, në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

(2) Nëse kryerësi e paguan gjobën në afat prej tetë ditë nga dita e dhënies së urdhërpagesës të kundërvajtjes, do ta paguajë gjysmën e gjobës së paraparë, ndërsa nëse nuk e paguan në afatin e paraparë, personi i autorizuar zyrtar do të parashtrorë kërkesë për ngritje të procedurës së kundërvajtjes të organi kompetent.

(3) Formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës së kundërvajtjes e përcakton ministri kompetent për çështje nga sfera e punës."

Neni 6

Neni 13 ndryshohet si vijon:

(1) Gjobë në shumë prej 500 deri në 1.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet mikro punëdhënësit dhe punëdhënësit të vogël - person juridik, gjobë në shumë prej 1.000 deri në 2.000 euro në kundërvlerë me denarë punëdhënësit të mesëm - person juridik dhe gjobë në shumë prej 2.000 deri në 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet punëdhënësit të madh - person juridik, nëse:

- kryen veprimtari e cila nuk është regjistruar në regjistrat tjerë të veçantë, të përcaktuara me ligj, përveç në regjistrin tregtar (neni 6 paragrafi (1) alineja 1 të këtij ligji),

- nuk ka me ligj akt të përcaktuar për plotësimin e kushteve për kryerje të veprimtarisë, në pajtim me ligjin (neni 6 paragrafi (1) alineja 2 të këtij ligji),

- personi tjetër, si bashkëpjesëmarrës, i mundëson kryerje të veprimtarisë të paregjistruar (neni 7 paragrafi (1) të këtij ligji),

- është bashkëpjesëmarrës në kryerjen e veprimtarisë së paregjistruar (neni 7 paragrafi (2) të këtij ligji),

- si porositës, nuk dorëzon të dhëna për identifikim (neni 8 paragrafi (1) të këtij ligji),

- konkursi publik i porositësit është shpallur pa të dhënat e nevojshme për veprimtari të regjistruar, në pajtim me këtë ligj (neni 8 paragrafi (2) të këtij ligji),

- të dhënat për identifikim të shfrytëzuara gjatë shpalljes, nuk ruhen në afatin e përcaktuar (neni 8 paragrafi (3) të këtij ligji) dhe

- nuk u lejon organeve kompetente të kryejnë këqyrje në të dhënat për identifikim, në pajtim me këtë ligj (neni 8 paragrafi (4) të këtij ligji).

(2) Gjobë në shumë prej 150 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) të këtij neni personit përgjegjës të personit juridik te mikro dhe punëdhënës i vogël, gjobë në shumë prej 300 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet punëdhënësit të mesëm dhe gjobë në shume prej 400 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet punëdhënësit të madh.

(3) Gjobë në shumë prej 250 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) të këtij neni punëdhënësit - person fizik.“.

Neni 7

Neni 14 ndryshohet si vijon:

"Gjobë në shumë prej 150 deri në 250 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje - personit fizik, nëse:

- kryen veprimtari e cila nuk është e regjistruar te organ kompetent (neni 6 paragrafi (1) alineja 3 të këtij ligji),
- kryen veprimtari për të cilën nuk ka akt të përcaktuar me ligj (neni 6 paragrafi (1) alienoj 4 të këtij ligji) dhe
- kryen veprimtari në kundërshtim me ndalimin për kryerje të veprimtarisë (neni 6 paragrafi (1) alineja 5 të këtij ligji).".

Neni 8

Neni 15 ndryshohet si vijon:

"Për kundërvajtjet e përcaktuara nga nenet 13 dhe 14 të këtij ligji, procedurë të kundërvajtjes mban dhe sanksion kundërvajtës shqipton gjykata kompetente.”.

Neni 9

Nenet 16, 16-a dhe 17 shlyhen.

Neni 10

Në tërë tekstin e ligjit fjalët: “Republika e Maqedonisë” zëvendësohen me fjalët: “Republika e Maqedonisë së Veriut”, ndërsa fjalët: “Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë” zëvendësohen me fjalët: “Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Neni 11

Aktet nënligjore të parapara në këtë ligj do të miratohen në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 12

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për ndalim dhe parandalim të kryerjes së veprimtarisë së paregjistruar.

Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".